

VENDIM
Nr. 684, datë 15.10.2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 419, DATË 14.4.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E AFATEVE DHE TË SKEMËS SË SHPËRNDARJES SË FONDEVE TË DËMSHPËRBLIMIT PËR ISH-TË DËNUARIT POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 32, të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 419, datë 14.4.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së dëmshpërblimit për ish - të dënuarit politikë të regjimit komunist, sipas planifikimit vjetor buxhetor dhe parimit të proporcionalitetit, në një raport prej 70% për të gjitha subjektet përfituese parësore, të përcaktuara në pikën 4, të këtij vendimi, dhe 30% për trashëgimtarët e ish - të dënuarve, që nuk bëjnë pjesë në kategorinë parësore.

Me shlyerjen përfundimtare të dëmshpërblimit të subjekteve parësore, të përcaktuara sipas pikës 7, të këtij vendimi, i gjithë buxheti vjetor kalon për dëmshpërblimin e trashëgimtarëve të ish - të dënuarve politikë.”.

2. Pika 5 shfuqizohet.

3. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Kësti pasardhës për kategorinë parësore përcaktohet me urdhër të ministrit të Financave, pas raportimit të drejtorisë përkatëse të dëmshpërblimit për ish - të përndjekurit politikë.”.

4. Në pikën 7 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Ministria e Financave, sipas buxhetit të vënë në dispozicion, shpërndan kështu e dëmshpërblimit, për kategoritë parësore, sipas ligjit, me radhë përparësie.

Shpërndarja e dëmshpërblimit, për subjektet përfituese të kategorisë parësore, për të njëjtin kësht, do të kryhet sipas kësaj radhe:

a) Ish - të dënuarit politike gra që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës;

b) Ish - të dënuarit politikë që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës dhe që kanë moshën mbi 75 vjeç, me hyrjen në fuqi të këtij ligji;

c) Ish - të dënuarit politikë, të cilët vuajnë sëmundje të rënda, sipas përcaktimit të aktit nënligjor të posaçëm;

ç) Ish të - dënuarit politikë që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës, të cilët, pavarësisht moshës, kanë pasardhës të radhës së parë në moshë të mitur, me hyrjen në fuqi të këtij ligji;

d) Ish - të dënuarit politikë që nuk jetojnë dhe që kanë trashëgimtarë të radhës së parë, të cilët janë në moshë të mitur me hyrjen në fuqi të këtij ligji;

dh) Ish - të dënuarit politikë që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës dhe që kanë moshën nën 75 vjeç me hyrjen në fuqi të këtij ligji.”

b) Pas paragrafit të parë, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Me kryerjen e pagesës për të gjitha kategoritë parësore, brenda kështit, fillon pagesa e kështit

pasardhës”.”

5. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministri i Financave, dy muaj përpara mbylljes së vitit buxhetor, vlerësojnë procesin e realizimit të fondeve për të dyja grupet e subjekteve përfituese dhe vendosin rishpërndarjen e fondeve ndërmjet dy grupeve.”.

6. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama